

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“Alushi Group” SH.P.K

Sot, më datë 22/11/2021, Unë I nënshkruari:

Klevis Alushi, I biri I Ganiut, lindur më 29/04/1991, në Lushnjë, mbajtës i pasaportes me nr. BA5173689, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në përputhje me ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” kam vendosur të themeloj një Shoqëri për Përgjegjësi të Kufizuar të emëruar “Alushi Group” SH.P.K (më poshtë referuar si “Shoqëria”), duke nënshkruar këtë Akt Themelimi. Aktiviteti I kësaj shoqërie do të rregullohet tek Statuti I saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij Akti Themelimi dhe i bashkëngjitet si Shtojca 1.

Neni 1


Emri i shoqërisë është “ Alushi Group ” SH.P.K

Neni 2

Selia zyrtare e shoqërisë ndodhet në adresën Lagja Skënder Libohova, Rruga Misto Mame, Pallati Nr.50, Zona kadastrale 8571, Lushnjë, Shoqëria ka të drejtë të hapë filiale apo degë në të gjithë vendin.

Neni 3

Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë do të jetë e pakufizuar mbi 10 vjet, duke filluar prej datës së regjistrimit të saj në Regjistrin e Shoqërive Tregtare të QKR. Shoqëria mund të përfundojë apo vihet në likuidim përpara këtij afati ose mund të zgjasë aktivitetin e saj me vendim të Ortakut të Vetëm.



Neni 4

Objekti I Shoqërisë është si vijon:

Import-Eksport, tregetim, instalim, mirembajtje i pajisjeve elektronike, telekomunikacionit etj.

Projektim, zhvillim, mirembajtje i rrjeteve te telekomunikacionit me fibra optike, kabell, wireless

Sherbime Interneti, telefonie, audio vizive me kabell, fibra optike, radio, wireless etj.

Megjithatë shoqëria ka të drejtë që të shtojë objektin e veprimtarisë së saj me vendim të administratorit si dhe shoqëria mund të marrë përfaqësime, të hapë agjensi dhe të ngreje filiale në të gjithë vendin.

Neni 5

Kapitali themeltar i shoqërisë I deklaruar nga ortaku është 100,000 (njëqindmijë) Lek, i cili ndahet në 1 pjesë, me vlerë prej 100,000 Lek.


Kapitali zotërohet nga ortakët e Shoqërisë si vijon:

Ortaku i vetëm Z. Klevis Alushi, zotëron 100% të kapitalit.

Ky kapital mund të shtohet sipas dispozitave ligjore dhe sipas vendimit të ortakut të vetëm.

Neni 6

Pjesët e kapitalit janë të transferueshme ndaj të tretëve tërësisht apo pjesërisht, sipas procedurave të parashikuara në Statutin e Shoqërisë.

A handwritten signature in black ink, consisting of several loops and a long horizontal stroke at the end.

Neni 7

Shoqëria ushtron aktivitetin e saj nëpërmjet Vendimeve të Ortakut të saj të vetëm.

Administrator i shoqërisë është Z. Klevis Alushi, I biri I Ganiut, lindur më 29/04/1991, në Lushnjë, mbajtës i pasaportes me nr. BA5173689, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.


Administratori do ketë një mandat për një periudhë pesëvjecare me të drejtë rizgjedhje.

Ortaku I vetëm mund të vendosë lejimin e një shpërblimi në favor të Administratorit për kryerjen e detyrës përveç pagimit të shpenzimeve.

Administratori ka liri të plotë për drejtimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë dhe mund të kryejë të gjitha llojet e veprimeve dhe cdo lloj marrëveshje për realizimin e qëllimeve të shoqërisë duke përjashtuar rastet që janë të parashikuara në ligj dhe në Statut që i takojnë Ortakut të vetëm. Raporti I administrimit, inventari dhe llogaritë vjetore, hartohen nga Administratori.

Neni 8

Kontrolli mbi veprimtarinë e shoqërisë si dhe gjithë aktivitetin e shoqërisë I besohet një ekspertit ose revizori kontabël. Ky ekspert do të qëndrojë në detyrë për aq sa përcakohet me ligj dhe mund të rizgjidhet. Ortaku I vetëm cakton dhe shpërblimin përkatës kur nuk ka norma të vecanta ligjore.

A handwritten signature in black ink, consisting of several loops and a long horizontal stroke at the end.

Neni 9


Ortaku I vetëm I shoqërisë mund të delegojë kompetencat e tij vetëm për ato që I përkasin funksioneve të tij si administrator.

Neni 10

Akti i Themelimit është hartuar në 4 kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Nënshkruar nga Ortaku i Vetëm:

KLEVIS ALUSHI



Lushnjë më 22/11/2021

